



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. __prot.

Belsh më: 22. 04 .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-SHERBIM

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Hartim Projekti “Për ndërtimin e një vepre hidroteknike, kanal shkarkues dhe rikonstruksioni i linjës KUZ në qytetin e Belshit”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): projekte- 22114311-5

Vlera e fondit limit: **1 659 663**(nje million e gjashtëqind e pesëdhjetë e nente mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre)leke pa TVSH

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike ,kriteret e veçanta të kualifikimit është kryer nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit nr,57 datë 25.02.2026 ,referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 te VKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, që përcakton “ cmimet e botuara nga instituti i statistikave (INSTAT) ,ose /dhe te tjera zyrtare ,të njohura nga institucionet perkatese ,(si,pershëmbull ,nga organet tatimore dhe doganore, dhomat e tregtisë , në manuale etj.

Ne bazë t ë nenit 21 ,pika2 ,neni 35 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” ,neni 2, ,pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, tëVKM nr.285,datë 19.05.2021 te Keshillit të ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar ,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Belsh ka hartuar proceverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurë e sipërcituar, me përmbajtje si më poshtë :

Hartimi i dokumentave të tenderit u bë në përputhje me **ligjin Nr,162/2020 date 23.12.2020 “ Për Prokurim Publik” si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).**

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10,

Argumentimi:Ky kriter u vendos me mbështetje ne nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te

Prokurimit Publik”i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar , ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional te operatoreve ekonomik:

Sipas përcaktimeve të bëra ne shtojcës 9) te DST-ve (Kriteret e Pergjithshme te perzgjedhjes /Kualifikimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se , citojmë : ”1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në :a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtari profesionale;...2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët të regjistrohen në një nga regjistrat profesional ose tregtar.”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Shënim: “Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesa te veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: *“Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”*.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: *Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesateveçantatëkualifikimitduhettëpërfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së.*

Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që është plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qenë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës. Referuar sa më sipër duke qenë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

- 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2025** sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar);prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. dhe **vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin e fundit(këstet e maturuara), duke mbajtur në konsideratë edhe përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore(këstet e maturuara për vitin 2026).**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpapa publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2,nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Njësia e prokurimit përcaktoi kritere që janë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55 pika 4/b), të VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbime e mëparëshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit , që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*Përcaktimi I vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore së sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjëndjes dhëe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët , nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.*

Përvoja e mëparëshme është një element I domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik mbi bazë të vlerave të kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitet për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Ne nenin 55 “PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR” pika 4/b të vendimit të këshillit të ministrave me NR.285, DATË 19.05.2021“Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë :4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm .Lidhur me kërkesat për përvojat e ngjashme , vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara do të jetë: b)Për kontratat e mallërave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është e realizuar gjatë tri viteve të fundit , nga data e shpalles së njoftimit të kontratës.

Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal I kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për tu vendosur në DST . Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë detyruese, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e Prokurimit me objektin e mësipërme.

- 2.3.2** Operatori ekonomik duhet te paraqese, Liçence profesionale për shoqërinë, sipas VKM nr. 943, date 28.12.2016, e vlefshme për kategorite ne fushat e studimit dhe projektimt ne ndertim lëshuar nga MIE dhe/ ose MZHU dhe/ose nga cdo Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim, për këto kategori:

KAT 3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

a)- Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

Kat 5. PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE

b)- Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

f)- Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi- shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

Kat. 8. PROJEKTUES GJEODET

a) – Rilevime inxhinierike.

Kat. 9. STUDIM GJEOLOGO INXHINIERIK – HIDROLOGJIK

d)– Studime e projektme hidrogeologjike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Duke u bazuar në: VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, “Për miratimin e listës së profesioneve, kriterëve dhe procedurave për pajisjen me certifikatë profesionale dhe licencë në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit”; Ligjin Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar me Ligjin Nr. 119/2020;

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
3 – a	Objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate	Projekti përfshin projektimin dhe dimensionimin e të gjitha strukturave ndertimore, si kanali, muret mbajtëse dhe pusetat. Do kryhen llogaritjet për qendrueshmerine ndaj ngarkesave të ujit, tokës. Gjithashtu do përgatiten detajet teknike dhe specifikimet e materialeve për të garantuar siguri dhe jetegjatesi të veprës. Për këtë arsye kërkohet licencë për projektim konstruktor për realizimin e saktë të këtyre elementëve.
5 – b	Furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi	Kjo kategori licence është e nevojshme pasi projekti përfshin rikonstrukcionin e linjes KUZ dhe ndërtimin e kolektoreve të shkarkimit që sigurojnë largimin e ujerave të ndotura dhe atyre sipërfaqësore. Përfshirja e kësaj licence garanton që projekti të realizohet në përputhje me kërkesat teknike, funksionale dhe mjedisore për menaxhimin e ujerave.
5 – f	Vepra hidroteknike, marrje uji, shkarkime, vepra nga rezervuarë/lumenj/puse	Projekti parashikon nderhyrje hidroteknike për shkarkimin e ujerave nga liqeni. Kjo licencë mbulon projektimin e veprave si kanale shkarkuese, struktura kontrolli dhe dalje ujore, të cilat sigurojnë menaxhimin e prurjeve dhe niveleve të ujit. Përfshirja e kësaj licence garanton që nderhyrjet të realizohen sipas standarteve hidraulike dhe me siguri të lartë funksionale dhe mjedisore.
8 – a	Rilevime inxhinierike	Projekti kërkon matje topografike të detajuara të terrenit

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
9 – d	Studime e projektme hidrogjeologjike	ku do të shtrihet kanali kullues, përcaktimin e kuotave dhe pjerrësive. Pa këto të dhëna nuk mund të realizohet projektimi hidraulik dhe ndërtimi i rrjetit. Projektimet hidrogjeologjike ne kete project perfshijne studimin e ujerave nentokesore dhe nderveprimin e tyre me vepren. Inxhinieri gjeolog vlerson nivelin e ujerave nentokesore, rrjedhjet dhe ndikimin e tyre ne stabilitetin e kanalit dhe rrjetit te kanalizimeve. Gjithashtu, ai propozon masa per drenazhimin dhe mbrojtjen nga infiltrimi, duke siguruar funksionim te qendrushem dhe pa probleme te projektit.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje nje ekspert per ceshtjet mjedisore te pajisur me License/Certifikat për hartimin e Vlerësimit te Ndikimit në Mjedis(VNM) dhe auditimin mjedisor sipas legjislacionin ne fuqi, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme dhe certificate.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

***Argumentim:** Projekti zhvillohet në një zonë me burime natyrore dhe ekosisteme të ndjeshme, ndaj kërkohet vlerësimi i ndikimeve mjedisore të ndërhyrjeve të propozuara. Eksperti i mjedisit siguron që projekti të jetë në përputhje me legjislacionin mjedisor, të minimizojë ndikimet negative dhe të promovojë përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe tokësore, bazuar ne Ligjin Nr. 128/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, Neni 24 “Certifikata për hartimin e raportit të VNM-se”.*

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të kete te punësuar mesatarisht të paktën **4 (kater) punonjës** për periudhen **Shkurt 2026 – Prill 2026**.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, per periudhen e fundit te deklaruar ,ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kerkuar;
- Listepagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohe nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: per percaktimin e fuqise punëtore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References.Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje gjashte muajt e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrate tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

Numri mesatar prej 4 punonjesish lidhet me numrin e inxhinierëve kryesor projektues te ketij projekti. Ky staf duhet te perfshije inxhinierë ne fushat hidroteknike, konstruktive, gjeologjike, topografike, te cilet jane te domosdoshem per analizen e kushteve te terrenit, projektimin e strukturave dhe garantimin e funksionimit te sigurt te sistemit. Kjo kerkese eshte proporcionale me kompleksitetin e projektit dhe lidhet drejteperdrejt me objektin e kontrates, duke siguruar nje projektim te plote, te qendrueshem dhe ne perputhje me standartet teknike.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë ne Licensen e Shoqërisë stafin si me poshte, vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome, licence profesionale individuale dhe te jene te perfshire ne Listpagesën e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetesore dhe TAP, si me poshte :

- 1 (një) inxhinier hidroteknik,
- 1 (një) inxhinier gjeodet,
- 1 (një) inxhinier gjeolog
- 1 (nje) inxhinier konstruktiv;

a) Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Liçencat profesionale personale të projektimit, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shkurt 2026 – Prill 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listë pagesat perkatëse.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Komisioni për vendosjen e stafit i është referuar Termave të përgjithshme të references për objektet pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen. Bazuar ne Ligjin nr. 107/2014, i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 8402/1998, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”; VKM nr. 943, datë 28.12.2016, për kriteret dhe procedurat e licencimit të profesionistëve në fushën e zhvillimit të territorit; Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 45, pika 1, shkronja “a”, kërkon që operatorët të demonstrojnë kapacitetet teknik dhe profesional të mjaftueshëm.

Duke marrë në konsideratë natyrën e projektit, që përfshin punime hidraulike, matje topografike, analiza gjeologjike dhe hidrologjike, projektim strukturor, prania e këtij stafi është e domosdoshme për garantimin e cilësisë, saktësisë teknike dhe realizimit me sukses të projektit. Kjo kërkesë është në përpjesëtim të plotë me objektin e prokurimit dhe nuk përbën kufizim të konkurrencës, por një garanci për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë

STAFI KËRKUAR	PËRSHKRIMI ROLIT	ARGUMENTIMI
Inxhinier Hidroteknik	Projektim dhe dimensionim i veprave hidraulike dhe rrjeteve të ujitjes	Inxhinieri hidroteknik është thelbesor në këtë projekt pasi ai siguron analizen dhe projektimin e sakte të levizjes dhe menaxhimit të ujërave. Ai realizon studimet hidrologjike dhe hidraulike, përcakton prurjet, dimensionon kanalën dhe strukturat e shkarkimit për të shmangur permbytjet dhe problemet me drenazhimin. Gjithashtu, garanton që sistemi të funksionojë në mënyrë efektive dhe të sigurt, duke mbrojtur si zonën urbane ashtu dhe ekosistemin e liqenit.
Inxhinier Gjeodet	Matje topografike, rievime dhe përpunim i të dhënave gjeohapësinore	Projekti kërkon matje të sakta topografike për përcaktimin e kuotave, pjerrësive dhe trasimit të rrjetit të ujitjes. Inxhinieri gjeodet realizon rievimet në terren, e cila është thelbësore për zbatimin korrekt të projektit.
Inxhinier Gjeolog	Studimi i kushteve gjeologjike dhe hidro-gjeologjike të terrenit	Zona e projektit karakterizohet nga kushte të veçanta gjeologjike dhe prani e ujërave nëntokësore. Inxhinieri gjeolog analizon përbërjen e tokës, qëndrueshmërinë e terrenit dhe ndikimin e ujërave nëntokësore në projekt,

**Inxhinier
Konstruktiv**

Projektim strukturor i
objekteve dhe veprave
mbështetëse

duke garantuar që rrjeti dhe veprat shoqëruese të projektohen në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme.

Projekti përfshin projektimin dhe dimensionimin e të gjitha strukturave ndertimore, si kanali, muret mbajtëse dhe pusetat. Do kryhen llogaritjet për qëndrueshmëri ndaj ngarkesave të ujit, tokës Gjithashtu do përgatiten detajet teknike dhe specifikimet e materialeve për të garantuar siguri dhe jetgjatësi të veprës. Për këtë arsye kërkohet inxhinieri konstruktor për realizimin e saktë të këtyre elementëve.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera:

- 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike GPS ose 1(nje) Pajisje për matjet gjeodezike Total Station;

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, ” përpam publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, pajisjet topografike e asete të tjera fizike, aftësitë organizative etj. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave..

Objekti i prokurimit përfshin hartimin e projektit të rrjetit të furnizimit me ujë për ujitje, i cili kërkon realizimin e matjeve të sakta topografike për përcaktimin e kuotave, pjerrësive dhe trasimit të rrjetit. Saktësia e këtyre matjeve është thelbësore për projektimin hidraulik dhe funksionimin korrekt të sistemit të ujitjes. Pajisjet gjeodezike si GPS ose Total Station mundësojnë mbledhjen e të dhënave të sakta në terren dhe janë të domosdoshme për hartimin e bazës topografike mbi të cilën zhvillohet projekti.

II. Argumentimi specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga : Referuar procesverbalit nr 1057 prot date 14.04.2026 janë hartuar në varësi të objektit të kontratës nga Komisioni i hartimit të fondit limit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit krijuar me Urdhër, ku bashkëlidhur ka dërguar kriteret e vecanta të kualifikimit, termat e referencës plotësojnë kushtet e përcaktuara mbështetur në VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, në varësi të objektit të

kontratës përcjell sipas termave të referencës me nr 879 datë 26.03.2026 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike krijuar me urdhërin nr,28 datë 28.01.2026

*Specifikimet teknike të hartuara për mallra objekt prokurimi, përshkruajnë elementet me të rëndësishëm përbërës , që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 4 , pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 2 e VKM nr.285, datë 19.05.2021''Per miratimin e rregullave prokurimit publik'' i ndryshuar, **duke argumentuar cdo kërkesë funksionale ose performance, dhe cdo standard të kërkuar**, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.*

NJËSIA E PROKURIMIT PUBLIK: